



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANE**

**V E N D I M**

Nr. 24, datë 10. 11. 2014

**PËR  
“MIRATIMIN E TREGUESVE TË REALIZIMIT TË BUXHETIT  
TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2013”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 19, pika 4 dhe 5, dhe nenit 32 gërma “dh” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000, për "Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" (i ndryshuar); ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” ; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.53, datë 24.12.2012 për “ Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2013-2015 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2013”; Urdhëresës Nr.80 datë 28.01.2013 për “ Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit të Bashkisë së Tiranës” dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë treguesit e realizimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2013 sipas relacionit dhe pasqyrave nr.1, 2, 3, dhe nr. 4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe të gjitha strukturat e tjera përkatëse të Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**ALDRIN DALIPI**